



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Drejtoria e Prokurimeve

Date ____ .02.2022

Nr ____ Prot

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR**

Date 04.02.2022

Drejtuar: Shoqërië “Tome Gaz”shpk, adresa: Korçë, Rruga nacionale Korçë-Tiranë, Zona kadastrale 1310, nr.pasurie 119/8

* * *

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar - Marrëveshje kuadër**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-16919-01-06-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës Blerje gaz i lëngshëm (per nevoja te Qendres Sportive Korçë sh.a

Kjo marrëveshje kuader ka per qëllim blerjen e gazit per nevoja te Qendres Sportive te Femijeve Korçë.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr 01 date 10 janar 2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Shoqëria “Tome Gaz” NIPT L74630001S me vlerën :

5,906,185.6 (pesë milion e nëntëqind e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtë)
lekë, pa tvsh

Marzhi i fitimit 8 lek/liter,pa tvsh.

2. Shoqëria “Gas Group” NIPT K81811016Q me vlerën:

6,585,600 (gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) lekë, pa tvsh.

* * *

Jane s'kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria "Gas Group" shpk me arsyen se:

1. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 1.a, per arsye se ne formularin e vetdeklarimit sipas shtojces 8, ne piken A-DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME TE KUALIFIKIMIT, nuk jane shenuar Personi/personat ne cilesine e anetarit te organit administrativ, drejtorit ose mbikeqyresit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi perfaqesuese, vendimarrese ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik per te cilet ofertuesi duhet te deklaronte se nuk jane te denuar sipas parashikimeve te nenit 76 te LPP.

Pra nuk eshte bere plotesimi i kesaj shtojce sipas kerkesave te saj dhe si rrjedhim autoriteti kontraktor nuk mund te beje verifikimet per gjendjen gjyqesore sipas parashikimeve te shkreses te perbashket te APP Nr 1155 Prot dhe Ministrisë të Drejtësisë Nr 1001/1 Prot datë 01.02.2019.

2. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, **pika 2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar , per arsye se ofertuesi nuk ka paraqitur Vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare 2018,2019,2020.**

3. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, **Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.1 per arsye se nuk ka paraqitur dokumentacion per te vertetuar kryerjen e furnizimeve te meparshme te ngjashme.**

4. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, **Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.2 per arsye se nuk ka paraqitur licence ose autorizim per ushtrim aktiviteti.**

5. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim, pika 2.3.1, pika 2.3.2 dhe pika 2.3.3 per arsye se nuk ka dorezuar raport analize te cilesise te gazit dhe asnje nga deklaratat e kerkuara ne pikat 2.3.2 dhe 2.3.3.**

6. Nga shqyrtimi i ofertes ekonomike te kesaj shoqërie, rezultoi se oferta kishte problemet si me poshte vijon:

Ofertuesi nuk ka detajuar oferten sipas percaktimeve te bera ne nenin 45 pika 2.1 e VKM Nr 285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar dhe piken 4.3 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, te percaktuar ne DST si me poshte :

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Bazuar ne nenin 45 pika 2.1 e VKM Nr 285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar:

Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

- a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletin e Njoftimeve Publike;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Dhe sipas sqarimeve te bera ne shtojcen 2 Lista e cmimeve ne piken 3.1 ku percaktohet shprehimisht se

3.1. Formulari i ofertës të përfshijë elementët si më poshtë:

a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftime Publike;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.”

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. Shoqëria “Tome Gaz” NIPT L74630001S me vlerën :

Vlera e ofruar : 5,906,185.6 (pesë milion e nëntëqind e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtë) lekë, pa tvsh.

Marzhi i fitimit 8 lek/liter,pa tvsh.

* * *

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**